



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM / KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. i dokumentit: 23.10.1-2010-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMPANISË
RAJONALE TË MBETURINAVE “PASTRIMP”- PRISHTINË**

PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2010

Prishtinë, Korrik 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
I. Hyrje	5
II. Opinioni i auditimit.....	6
III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara	7
IV. Shpenzimet në krahasim me të Hyrat	8
V. Pasqyrat financiare.....	10
V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm	10
V.2 Cilësia e informatave	10
VI. Realizimi i Buxhetit	11
VI.1 Menaxhimi i të hyrave	11
VI.2 Shpenzimet.....	12
VI.3 Pasuritë dhe Borxhet.....	15
VI.4 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	17
VII. Sistemet e Kontrollit të Brendshëm	18
VII.1 Auditimi i Brendshëm.....	19
VIII. Konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Kompanisë	20
Shtojca I. Komentet e KRM “ Pastrimi” dhe përgjigjja e ZAP-it.....	21
Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	21

Lista e shkurtesave

AK	Autoriteti Kontraktues
AP	Auditori i Përgjithshëm
APP	Agjensioni për Prokurim Publik
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Banka Ekonomike
BpB	Banka private e Biznesit
BKP	Banka Kreditore e Prishtinës
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KRM	Kompania Rajonale e Mbeturinave
KMSH	Kosto e Mallit të Shitur
LMFPP	Ligji Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji Për Prokurimin Publik
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NLB	Nova Lulblanska Banka
NP	Ndërmarrja Publike
OE	Operatori Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
SHA	Shoqëri Aksionare
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UA	Udhëzimi Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave (KRM) “Pastrimi”-Prishtinë (në tekstin e mëtejme “Kompania”) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Gjatë formulimit të opinionit ne vlerësuam mjaftueshmërinë e prezantimit të informacionit në pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë pasqyrat kryesore financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se sa i përket paraqitjes së të arkëtueshmeve dhe vlerësimit të provizioneve për borxhet e këqija. Kompania nuk ka pasur një politikë adekuate të njohjes së provizioneve për borxhet e këqija dhe të dyshimta. Ajo ka provizionuar si borxhe të këqija dhe të dyshimta të gjitha të hyrat e painkasuara.

(ISSAI 400: Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes).

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara më detajisht në brendi të raportit, të cilat duhet të adresohen nga menaxhmenti për të përmirësuar performancën e organizatës.

Për vitin 2009 ishin dhënë 11 rekomandime, prej tyre katër ishin adresuar ndërsa shtatë tjera nuk ishin në proces të implementimit.

Rekomandimi ynë kryesor është që Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj se janë zhvilluar udhëzime dhe procedura të qarta të cilat duhet të ndihmojnë adresimin e dobësive dhe mangësive të identifikuara në këtë raport.

Ne rekomandojmë që veçanërisht të siguroni:

- Se në Pasqyrat Vjetore Financiare janë përfshirë shënime shpjeguese dhe shpalosjet;
- Që Kompania bën analizë dhe trajtim të duhur të arkëtueshmeve;
- Vlerësimin e drejtë të provizioneve për borxhet e këqija dhe të dyshimta;
- Vlerësimin e drejtë dhe transparent gjatë rekrutimit të stafit;
- Se Kompania do të komplettoj kornizën e duhur ligjore të kërkuar me ligjin për NP;
- Se procedurat e prokurimit janë zhvilluar në përputhshmëri të plotë me LPP;

- Regjistrimin e pasurisë jo financiare; dhe
- Themelimin e Njesisë së auditimit të brendshëm dhe komisionin e Auditimit.

Menaxhmentit të Kompanisë i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti.

Menaxhmenti i Kompanisë i ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi pasqyrat financiare për vitin 2010 dhe është zotuar që do të bëjë të përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

I. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me Pasqyrat Vjetore Financiare të për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Është përgjegjësi e “Kompanisë” të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Raportimin Financiar në bazë të parimit akrual të kontabilitetit.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi kryer auditimin e ndërmjetëm të “Kompanisë”. Gjatë asaj faze të auditimit, kemi adresuar faktin se si janë trajtuar rekomandimet e mëparshme si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Po ashtu, kemi këshilluar menaxhmentin për adresimin e çështjeve në pasqyra financiare, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në dhjetor 2010.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive tona për auditimin e “Kompanisë”, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar Pasqyrat Vjetore Financiare të “Kompanisë” për vitin 2010;
- Kemi përcaktuar nëse PVF-të e “Kompanisë” janë përgatitur në pajtim me SNRF “Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar”;

- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare; dhe
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2010.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të “Kompanisë” standardet ndërkombëtare të auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 2.

II. Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat kryesore financiare *në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.*

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se sa i përket paraqitjes së të arkëtueshmeve dhe vlerësimit të provizioneve për borxhet e këqija. Kompania nuk ka pasur një politikë adekuate të njohjes së provizioneve për borxhet e këqija dhe të dyshimta. Ajo ka provizionuar si borxhe të këqija dhe të dyshimta të gjitha të hyrat e painkasuara. **(ISSAI 400: Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes).**

III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Në raportin tonë të auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të vitit 2009 ishin dhënë njëmbëdhjetë (11) rekomandime. Prej këtyre rekomandimeve, katër janë adresuar plotësisht si themelimi i Bordit të Drejtorëve, regjistrimi i shpenzimeve sipas planit kontabël, shpenzimet operative përfshirë në KMSH dhe vendosja e bar kodeve ndërsa të tjera janë në proces të implementimit. Rekomandimet në proces janë:

- Pasqyrat Financiare të përgatiten në pajtim me SNK dhe ligjet e aplikueshme në vend, duke përfshirë pesë komponentët e saj;
- Të rishikohet çështja e të arkëtueshmeve dhe provizioneve për borxhet e këqija në bashkëpunim me organet qendrore, përkatësisht aksionaret e saj;
- Mungesa e forcimit të kontrollit në Departamentin e Burimeve Njerëzore, veçanërisht sa i përket rekrutimit të stafit;
- Te procedurat e prokurimit ende janë vërejtur parregullsi duke filluar nga faza e planifikimit deri të faza e realizimit të tyre;
- Kompania nuk ka arritur të nxjerr dhe të kompletoj të gjitha rregulloret për dhurata bamirëse për punëtorët e kompanisë të cilat kërkohen me ligjin për NP-të;
- Që të forcoj edhe më tutje kontrollin në menaxhimin e pasurive; dhe
- Themelimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe komisionin e auditimit.

Dështimi në implementimin e plotë të rekomandimeve të kaluara është tregues se në këtë Kompani ekzistojnë problemet e njëjta si edhe vitin e kaluar.

IV. Shpenzimet në krahasim me të Hyrat

Analiza e Shpenzimeve në Pasqyrat Financiare kundrejt të Hyrave tregon:

Tabela 1: Përshkrimi i të hyrave dhe shpenzimeve Në euro (€)

Zërat/Vitet	Planifikimi për vitin 2010	Të hyrat dhe shpenzimet 2010	Të hyrat dhe shpenzimet 2009
Të hyrat e faturuara	3,359,707	4,213,096	4,010,772
Të hyrat e tjera	993,012	239,718	187,803
Totali	4,352,719	4,452,814	4,198,575
KMSH	-	(469,345)	-
Fitimi Bruto	4,352,719	3,983,469	4,198,575
Pagat Bruto	1,565,320	1,617,827	1,462,665
Mirëmbajtja dhe riparimet	191,812	150,520	163,457
Shpenzimet Administrative	144,613	44,461	40,042
Rryma Elektrike, Komunalitë	43,598	26,190	5,195
Shpenzimet e Derivateve	725,135	403,599	444,491
Shpenzimet e Qirasë	139,307	4,400	5,000
Shlyerja e Borxheve të këqija	650,000	1,207,000	1,151,621
Shpenzimet tjera operative	872,640	207,935	698,068
Gjithsej shpenzimet operative:	4,332,425	3,661,932	3,970,539
Zhvlerësimi i Mjeteve të Punës	228,506	277,442	184,396
Zhvlerësimi i Ndërtesave	88,280	44,153	44,110
Gjithsej zhvlerësimi:	316,786	321,595	228,506
Neto Fitimi (Humbja)	(296,492)	(58)	(471)

Sipas tabelës shihet se Kompania gjatë periudhës dy (2) vjeçare ka pasur një rezultat financiar negativ. Nga tabela me lartë mund të vërehet se “Kompania” gjatë vitit 2010 ka arritur të realizoj të hyra 4,452,814€ Nëse i krahasojmë të hyrat sipas viteve shohim se gjatë vitit 2010 të hyrat janë rritur për 254,239€ose rreth 6%.

Krahasuar me vitin paraprak, shpenzimet operative ishin më të ulëta për 308,607€ose 9%. Si rezultat i kësaj, gjatë vitit 2010 “Kompania” ka një rezultat më të mirë financiar duke minimizuar humbjen në vetëm 58€

Nga tabela më lart, vërehet se “Kompania” gjatë vitit 2010 kishte një rritje të theksuar të shpenzimeve tek shpenzimet e energjisë për shkak të ndryshimit të faturimit nga KEK. Kjo ka ndodhë për faktin se në vitin paraprak faturimi ka qenë në mënyrë paushalle, ndërsa në vitin 2010 faturimi është bërë në bazë të shpenzimeve faktike.

Tabela 2: Pasqyra e Bilancit të Gjendjes

Zërat/Viti	2010	2009
Mjetet Qarkulluese	2,952,541	2,483,319
Arka dhe Xhirollogaria	373,493	323,881
Llogari të Arkëtueshme	13,905,740	12,309,874
Kërkesat tjera Afatshkurtëra	17,933	19,435
Shpenzimet e parapaguara dhe të hyrat Akruale	6,941	699
Huaja e dhënë	15,000	
Stoqet	35,818	37,337
Provizionet	(11,402,384)	(10,207,908)
Mjetet Fikse	6,216,116	6,525,347
Zhvlerësimi	(819,548)	(506,639)
Impiantet, pajisjet, makinat	1,407,609	1,404,781
Ndërtesat	883,055	882,205
Toka	4,745,000	4,745,000
Gjithsej Asetet	9,168,657	9,008,666
Gjithsej detyrimet Afatshkurta	3,362,642	5,572,054
Llogaritë e Pagueshme	1,468,747	1,243,835
Tatimi i Pagueshëm në të Ardhura	1,775,843	1,685,160
Shpenzimet Akruale dhe Avancet e marra	116,682	105,635
Tatimi në fitimit i periudhës raportuese	2,536,052	2,536,052
Detyrimet tjera Afatshkurtëra	1,370	1,370
Kapitali	5,806,015	3,436,612
Rezervat e Rivlerësuara	2,578,660	2,579,130
Dhuratat e Kapitalizuara	25,000	25,000
Fitimet e Bartura	(58)	(470)
Ndihmat, Grantet dhe dhuratat financiare (Ndihma nga qeveria për blerjen e Automjet.)	666,362	832,952
Gjithsej Detyrimet dhe Kapitali	9,168,657	9,008,666

Nga pasqyra e bilancit të gjendjes së paraqitur më lartë vërehet se KRM “Pastrimi” vite me radhë është duke operuar me humbje, andaj menaxhmenti i Kompanisë duhet të merr veprime konkrete për rimëkëmbjen e Kompanisë.

Në vitin 2010 në kuadër të provizioneve për borxhet e dyshimta është paraqitur shuma prej 11,402,384€ Politikë e “Kompanisë” është që të regjistroj si borxhe të dyshimta të gjitha borxhet e pa arkëtueshme. Kemi vërejtur se “Kompania” nuk bënë ndarjen e borxheve të vjetra nga borxhet e vitit vijues. Po ashtu, ekziston informacion i pamjaftueshëm për përgatitjen e një analize për vjetërsinë e borxheve të paraqitura si borxhe të dyshimta.

Llogaritë e pagueshme sipas raportimit financiar të kompanisë në vitin 2010 ishin 1,468,747€ apo rreth 18% më të larta se sa në vitin 2009. Problemi i tillë ndikon edhe në likuiditetin e kompanisë, sepse detyrimet e kompanisë janë rritur dhe aftësia për t’i paguar në afatet e parapara vë në pikëpyetje funksionimin normal të kompanisë. Problem serioz në këtë

kompani ende është gjetja e një mekanizmi i cili do të mundësonte një shkallë më të lartë të inkasimit.

V. Pasqyrat financiare

V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Kompania është e obliguar që Pasqyrat Vjetore Financiare t'i përgatitë në përputhje me SKK apo për çështjet që nuk rregullohen me standarde kombëtare, të përdoren SNK, dhe në pajtim me ligjet aplikative në Kosovë.

- P/F janë përgatitur sipas parimit akrual të kontabilitetit;
- P/F janë nënshkruar më 31 mars 2011 nga shefi i kontabilitetit dhe drejtori kryesor financiar;
- P/F janë përgatit vetëm në gjuhën shqipe;
- P/F janë dorëzuar në MEF/ (Administratën Tatimore) në datën 31 mars 2011; dhe
- Zyrtarët e kompanisë nuk kanë përgatitur raporte tre mujore në të cilat do të duhej të prezantohej përshkrimi i performancës afariste dhe financiare, ndryshimet në strukturën organizative, etj

V.2 Cilësia e informatave

Pasaktësitë në vijim nuk janë korrigjuar nga ana e Menaxhmentit dhe për këtë ne po raportojmë:

- Kompania ka përgatitur katër pasqyrat vjetore financiare, mirëpo i mungonte elementi i pestë i pasqyrave financiare shënimet shpjeguese dhe shpalosjet përkatëse; dhe
- Trajtimi i të arkëtueshmeve dhe provizionimi i borxheve të këqija dhe të dyshimta nuk ishte paraqitur në pajtim të plotë me standardet e kontabilitetit dhe ligjet e aplikueshme.

Konkluzioni

Pasqyrat Financiare nuk kanë shpalosur plotësisht të dhënat financiare siç kërkohet me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Rekomandimi 1

Përsërisim rekomandimin e vitit të kaluar se Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që:

- Pasqyrat Financiare të kompanisë të jenë të përgatitura në pajtim me SNK dhe ligjet e aplikueshme në vend, duke përfshirë katër pasqyrat dhe shpalosjet e tyre. Në pasqyrat e shpalosjeve veçanërisht të rëndësishme janë politikat e zhvlerësimit, baza për përgatitjen e pasqyrave financiare, detyrimet kontigjente, trajtimi i borgjeve të këqija, kreditë e marra etj; dhe
- Nxjerrjen e politikave të qarta dhe respektimin e kritereve për shlyerjen e borxheve të këqija.

VI. Realizimi i Buxhetit

VI.1 Menaxhimi i të hyrave

Të hyrat e përgjithshme të faturuara për vitin 2010, sipas raportimit financiar ishin 4,452,814€ Krahasuar me vitin 2009 është shënuar një rritje prej 254,239€apo 6%. Burimet kryesore të të hyrave në Kompani janë:

- Të hyrat (Faturimi) nga veprimtaria themelore në shumë prej 4,213,096€ dhe
- Të hyrat tjera 239,718€

Sipas raportimit financiar, nga të hyrat e faturuara dhe shërbimet kontraktuese, shkalla e inkasimit për vitin 2010 ishte 3,266,536€

Gjatë procedurave të ndjekura të auditimit, kemi identifikuar këto mangësi:

Prezantim dhe vlerësim jo i drejtë i inkasimit vjetor

Inkasimi i raportuar nga Kompania për vitin 2010 ishte 3,266,536€ Kjo vlerë nuk ishte shpalosur në pasqyrat financiare për të sqaruar se sa prej tyre u takojnë të hyrave të vitit 2010 dhe 2011..

Mungesa e politikave për rregullimin e lejimeve të borxheve të këqija dhe të dyshimta

Ne kemi vërejtur se kompania edhe gjatë këtij viti ka përdorur një sistem të kontabilitetit i cili nuk ofron mundësi për rregullimet e borxheve të këqija dhe të dyshimta.

Inaksime të mjeteve financiare

Përveç institucioneve publike të cilat paguajnë faturat, duke depozituar paranë e gatshme në llogarinë bankare të kompanisë, personat fizik dhe pronarët e bizneseve, obligimet e tyre i

paguajnë në të gatshme, të cilat inkasohen nga inkasantët në terren. Ne kemi vërejtur se në disa raste inkasantët në terren nuk i kanë depozituar paratë e mbledhura në arkën e kompanisë deri në 20 ditë.

Konkluzion

Mos zbatimi i rregullave të kontabilitetit për të pa arkëtueshmet, kur bëhet fjalë për rritjet apo zvogëlimet në lejimet e të arkëtueshmëve, mund të rezultoj në keq deklarim në pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve si dhe në bilancin e gjendjes. Po ashtu, praktika inkasimit të të hyrave në të gatshme bart rrezikun potencial për keqpërdorim.

Rekomandimi 2

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve të siguroj që:

- Të dhënat kontabël janë të mbështetura në politika të qarta dhe janë në pajtim me SNK, që rregullojnë borxhet e këqija dhe zbritjet e lejuara;
- Të bëjë shpalosjen e inkasimeve në mes të të hyrave nga viti aktual dhe inkasimeve nga borxhet e viteve paraprake; dhe
- Janë marrë masat e duhura që paratë e inkasura në terren, të paktën të derdhen në llogarinë bankare çdo të dytën ditë.

VI.2 Shpenzimet

Kompania nuk ka sistem specifik të kontabilitetit të shpenzimeve. Menaxhmenti duhet të përdor klasifikimin e shpenzimeve sipas planit kontabël. Në mungesë të sistemit adekuat të kontabilitetit të shpenzimeve, menaxhmenti nuk mund të kryej një analizë të duhur të shpenzimit për secilën njësi organizative.

2.1 Blerjet përmes prokurimeve

Ne kemi testuar disa mostra në prokurim dhe kemi konstatuar se KRM "Pastrimi" ka ndërmarrë procedurat e prokurimit të cilat nuk janë në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik.

Prokurime pa procedura

Me datën 12.04.2010 është blerë vetura "Golf-IV 1.9 TDI", prodhim i vitit 2002. Çmimi i furnizimit të kësaj veture ishte 7,500€ Po ashtu, me datën 11.10.2010 është blerë edhe vetura "Opel Astra" e vitit të prodhimit 2002, me çmimi prej 6,300€ Furnizimet në të dy rastet ishin bërë duke i anashkaluar të gjitha procedurat e prokurimit.

Po ashtu ne vërejtëm se kompania kishte kryer furnizime dhe montim të pjesëve për riparimin e automjeteve vetëm nga një OE, brenda një afati prej dy muajve, pa i respektuar

procedurat e prokurimit. Kompania nuk i kishte dërguar së paku tre (3) operatorëve ekonomik kërkesën për kuotim të çmimeve, siç kërkohet me LPP. Furnizimet e tilla ishin vërejtur në rastet e më poshtme:

- Furnizimi me motor të përdorur për Mercedes 17/26 me datën 02.07.2010, duke përllogaritur edhe demontimin dhe montimin në çmimin fitues në vlerë prej 2,000€
- Furnizimi me motor për kamionë 7m3 Mercedes 13/14, me datën 04.08.2010 me çmimin në shumë prej 1,500€
- Furnizim dhe montim i ndërruesit të shpejtësive për Mercedes 24/35 me datën 04.08.2010 në vlerë prej 1,200€ dhe
- Furnizimi me motor Man 232/6 cilindra me datën 06.09.2010 në vlerë prej 2,700€

Kryerja e shërbimeve me OE edhe pas skadimit të kontratës

Kontrata për deponimin mbeturinave me OE "KLMC" ka qenë e nënshkruar për periudhën prej 01.11.2007 deri 31.10.2009. Ne kemi testuar faturimin dhe pagesat për deponimin e mbeturinave për vitin 2010 në vlerë prej 20,000€ dhe vërejtëm se është bërë faturimi dhe pagesa sipas çmimit të kontraktuar me OE që i ka përfunduar afati i vlefshmërisë së kontratës.

Furnizim i artikujve të cilat nuk kanë qenë pjesë e listës së artikujve të kontraktuar

Nga testimi lëndës "Furnizim me goma të jashtme dhe të brendshme dhe bateri të automjeteve" vërejtëm se janë faturuar dhe paguar artikuj të ndryshëm në vlerë prej 4,098€ që nuk kanë qenë pjesë e listës së artikujve sipas specifikacionit të kontraktuar.

Konkluzion

Mos funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në nivelin e duhur ka rezultuar me mosrespektimin e procedurave të prokurimit, ekzekutimin e pagesave për artikujt të cilët nuk korrespondojnë me specifikacionin e kontraktuar, kryerja e shërbimeve me OE që i ka skaduar kontrata.

Veprimet e theksuara më lart rrisin rrezikun e keqmenaxhimit, humbjes ose keqpërdorimit të parave publike.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve që të siguroj:

- Se të gjitha furnizimet do të bëhen duke respektuar procedurat e prokurimit;
- Se të gjitha pagesat bëhen në pajtim me vlefshmërinë e kontratave; dhe
- Se asnjë pagesë nuk do të bëhet nëse nuk është në pajtim me kontratën dhe specifikacionin teknik.

2.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Sipas planit të biznesit për vitin 2010, buxheti për paga dhe mëditje në KRM "Pastrimi" ishte 1,565,320€ ndërsa sipas shënimeve në P/F në këtë kategori janë shpenzuar 1,617,827€ Numri i të punësuarve sipas planit të biznesit për vitin 2010, të miratuar nga ish Bordi i Drejtorëve, ishte 439 punëtorë, ndërsa të punësuar në kompani ishin 444 punëtor.

Ne kemi testuar dosjet e personelit për të rekrutuarit gjatë vitit 2010, ku kemi vërejtur se të punësuarit nuk janë rekrutuar me konkurs publik, por kandidatët janë pranuar nga evidencat e zyrës për punë dhe mirëqenie sociale. Po ashtu, kemi konstatuar se kompania nuk ka politikë të kompensimit të zyrtarëve, të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, siç kërkohet me ligjin e ndërmarrjeve publike. Kompensimi dhe kategorizimi i pozitave është rregulluar nga një komision i emëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Kompanisë.

Konkluzion

Tejkalimi i numrit të punëtorëve në raport me planin e biznesit dhe mungesa e një politike mbi kompensimin e zyrtarëve të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve mund të rezultojnë me një rritje jo racionale të shpenzimeve.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve që të siguroj:

- Hartimin e politikave të qarta për kompensimin e zyrtarëve në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike;
- Se punësimi do të bëhet në pajtim me planin e aprovuar të biznesit 2008/2011, të aprovuar nga Bordi; dhe
- Se pranimi i të punësuarve do të bëhet me konkurs publik.

2.3 Subvencionet dhe transferet

Prej kategorisë së subvencioneve, kompania ka paguar për dhurata bamirëse në formë monetare dhe në ndihma në shumë prej 48,760€ Rishikimet tona lidhur me zbatimin e procedurave mbi subvencionet kanë rezultuar me mangësitë e paraqitura në vijim:

Në bazë të vendimit të drejtorit menaxhues janë paguar 44,200 € në formë të pagesave për secilin të punësuar nga 100€ për festën e Vitit të Ri, 600€ me rastin e ditës ndërkombëtare të Gruas 8 Marsit, 430€ për mirënjohjen e dy punëtorëve për kontributin e dhënë. Ne nuk kemi gjetur ndonjë rregullore të brendshme e cila rregullon këtë formë për subvencionimin dhe stimulimin e punëtorëve.

Konkluzion

Mungesa e ndonjë rregullore, kornize ligjore apo udhëzimi të brendshëm për dhurata bamirëse për punëtorët e kompanisë, si dhe dhënia e mirënjohjeve për punëtorë të vet kompanisë, vë në pikëpyetje racionalitetin e këtyre shpenzimeve.

Rekomandimi 5

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve që të siguroj:

- Nxjerrjen e politikave, udhëzimeve dhe procedurave të qarta, si dhe zhvillimin e kritereve për ndarjen e subvencione.

VI.3 Pasuritë dhe Borxhet

3.1 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Paraja e gatshme në fund vitin 2010 ishte 373,493€.

Auditimi ynë ka shpalosur disa dobësi në menaxhimin e parasë duke filluar nga procesi i inkasimit, mbajtjes së parasë në arkë, si dhe bartjes së tyre deri në bankë. Këto dobësi lidhet me mungesën e një rregullore të qartë, e cila do të sqaronte këto procedura. Mungesa e kësaj rregullore ka shkaktuar pasiguri në menaxhimin e parasë në përgjithësi, gjë që përbën rrezik në vete për keqpërdorim.

Mos kthimi i mjeteve të huazuara

Ne kemi vërejtur se Kompania kishte bërë marrëveshje për huazimin e përkohshëm të mjeteve financiare në vlerë prej 15,000€ kompanisë “Eko-regjioni” Prizren. Kjo marrëveshje ishte e nënshkruar me datën 01.04.2010. Huazimi i mjeteve kishte të bëjë për mbulimin e obligimeve urgjente ndaj furnitorëve që kishte kompania KRM “Eko-regjioni”. Afati i kthimit të huasë ishte 25.04.2010. Mirëpo, kthimi i këtyre mjeteve nuk ishte bërë në afatin e përcaktuar. Ne gjatë fazës së auditimit u informuam se kompania KRM “Pastrimi” kishte bërë padi kundër huamarrësit në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë për kthimin e këtyre mjeteve.

Konkluzioni

Menaxhmeti nuk kishte arritur të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar kontrollin të kënaqshme të menaxhimit të parasë duke filluar prej inkasimit, deponimit, dhe përdorimit të mjeteve. Dhënia e huasë 15,000€, nën kushtet kur kompania ka detyrime afatshkurtëra gati 1,5 milionë, mund ta vështirësojnë gjendjen financiare të kompanisë edhe më shumë.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve që të siguroj;

- Përgatitjen e një udhëzuesi me procedura të qarta për menaxhimin e parasë së gatshme, duke filluar nga inkasimi, regjistrimi, transferet në llogari bankare e deri të raportimi; dhe
- Të siguroj se zyrtaret përgjegjës janë palë aktive në procedurat për kthimin e huasë.

3.2 Llogaritë e Arkëtueshme

Në Pasqyrat Financiare të Kompanisë janë prezantuar 13,905,740€ si llogari të arkëtueshme. Këto janë të akumuluar prej vitit 1999 deri në fund të vitit 2010. Kompania i ka deklaruar 11,402,384€ si borxhe të këqija dhe të dyshimta, pa ndonjë politikë të brendshme të shkruar. Përkundër rekomandimeve të dhëna nga auditimi i kaluar lidhur me trajtimin e të arkëtueshmeve, kompania nuk ka arritur ta adresoj këtë rekomandim.

Në vlerësimet tona të mëtutjeshme, kemi vërejtur:

Nivel i ulët i mbledhjes së të arkëtueshmeve dhe shpalosje e pamjaftueshme e tyre

Kompania nuk kishte arritur të mbledhë borxhet nga klientët e saj në një nivel të kënaqshëm, që si pasojë niveli i borgjeve të pa mbledhura është shumë i lartë. Po ashtu, në periudhën e vitit 2010, kompania ka shlyer borxhe të klientëve në vlerë prej 12,524€ për të cilat mungojnë shpalosjet e duhura dhe baza rregullative mbi procedurat e shlyerjes.

Trajtim dhe vlerësim jo i drejtë i provizioneve për borxhet e këqija

Në pasqyrat e saj financiare kompania ka prezantuar shpenzime të borxheve të këqija në vlerë prej 1,207,000€ që rrjedh si rezultat i të hyrave të pa inkasuara gjatë vitit 2010. Paraqitja e kësaj vlere si borxh i keq dhe i dyshimtë nuk ishte në pajtim të plotë me kërkesat e standardeve të kontabilitetit dhe ligjeve tatimore të Kosovës. Kjo kishte ndikuar në rezultatin financiar të kompanisë..

Konkluzioni

Kompania nuk kishte arritur të siguroj një regjistrim dhe raportim të llogarive të pa mbledhshme, të bazuar plotësisht në standardet e kontabilitetit dhe ligjet e aplikueshme tatimore të vendit.

Rekomandimi 7

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve të siguroj:

- Marrjen e veprimeve adekuate për mbledhjen e borxheve, duke siguruar mbështetje edhe nga aksionaret e saj, përkatësisht Komuna;
- Shpalosjet e duhura për shlyerjet e të arkëtueshmeve në Pasqyrat Financiare; dhe
- Që trajtimi i të arkëtueshmeve si dhe vlerësimi i provizioneve për borxhet e këqija dhe të dyshimta të bëhet në pajtim më SNK, standardet vendore dhe ligjet e aplikueshme në vend.

VI.4 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Mjetet themelore

Vlera e mjeteve themelore të kompanisë të paraqitura në Pasqyrat Financiare është 9,168,657€ Kompania nuk ka ndonjë softuer për administrimin e të dhënave të pasurive fikse. Kompania nuk vlerëson dhe rishqyrton jetëgjatësinë e aseteve. Kompania nuk identifikon rregullisht dhe nuk merr parasysh artikujt e dalur nga përdorimi. Nuk ka procedura që sigurojnë se shuma bartëse e një artikulli të pronës, objekteve dhe pajisjeve duhet të fshihet atëherë kur në të ardhmen nuk priten përfitime ekonomike nga përdorimi i saj. Me datën 08.12.2010 Drejtori Menaxhues i Kompanisë ka marr vendim për formimin e komisionit të inventarizimit vjetor të pasurive. Ky Komision nuk ka përgatitur raport në fund të vitit.

Konkluzioni

Mangësitë e vërejtura tregojnë që kompania duhet të angazhohet edhe më tutje që të forcoj sistemin e kontrollit të brendshëm lidhur me menaxhimin pasurive. Mos prezantimi i pasurive të cilat janë identifikuar si të papërdorshme, janë gabimet kyçe në menaxhimin e mjeteve themelore.

Rekomandimi 8

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve të siguroj që:

- Zyrtari i pasurive duhet të bëj evidentimin, përcjelljen dhe mirëmbajtjen e regjistrit gjithëpërfshirës të pasurive me të gjitha informatat që kërkohen;
- Të implementohet Programi i kontabilitetit për asetet fikse, për të regjistruar të gjitha asetet ekzistuese, plotësimet, shitjet dhe automatikisht të kalkulojë shpenzimet e zhvlerësimit për qëllime të kontabilitetit; dhe
- Komisionet për vlerësim dhe inventarizim të pasurisë të hartojnë raporte dhe të verifikojnë asetet që mungojnë, duke bërë harmonizimin në mes regjistrit kontabël dhe numërimit fizik.

VII.Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Sistemi i mirë i kontrollit të brendshëm e ndihmon çdo Kompani në arritjen e objektivave për shfrytëzimin sa më efektiv dhe efikas të resurseve.

Të gjeturat dhe konkludimet tona të prezantuara më lartë tregojnë se sistemet e kontrollit të brendshëm nuk kanë qenë të dizajnuara në mënyrë adekuate për të parandaluar gabimet dhe parregullsitë.

Dështimi për të themeluar më parë Bordin e Drejtorëve (ky bord është formuar me 11 Nëntor 2010) si dhe njësisë për auditim të brendshëm paraqesin dy nga problemet kyçe të fuqizimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Nga mungesa e kontrolleve adekuate janë vërejtur dobësi në: Nxjerrjen dhe kompletimin e një kornize rregullative për funksionimin e kontrollit të brendshëm të cilat kërkohen me ligjin e NP-ve; Mungesa e një mekanizmi për inkasimin e borxheve të vjetra; dhe Sisteme jo adekuate për regjistrimin dhe monitorimin e pasurive fikse, duke përfshirë në këtë kontekst edhe vlerësimin e pajisjeve të hedhura jashtë përdorimit.

Konkluzioni

Të gjeturat e paraqitura me lartë tregojnë se kompania nuk kishte arritur të siguroj një kornize ligjore që kërkohet sipas Ligjit të NP-ve, dhe të vendos një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm, të cilat do të ndihmonin kompaninë në përmirësimin e menaxhimit.

Ne konsiderojmë se niveli i kontrollit financiar do të mund të ishte përmirësuar nëse do të ekzistonte ma herët i formuar Bordi i drejtorëve dhe njësia për auditim të brendshëm.

Në përgjithësi, niveli i kontrollit të brendshëm nuk ishte mjaft funksional, dhe menaxhmenti i kompanisë duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për përmirësimin e tij.

Rekomandimi 9

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve të siguroj që:

- Një kornizë të brendshme ligjore e cila do të ndihmoj në funksionimin e kontrollit të brendshëm, dhe do të siguroj menaxhim efikas dhe efektiv të kompanisë; dhe
- Të dizajnojë dhe të vendosë një sistem funksional të kontrollit të brendshëm, duke kërkuar përgjegjësi dhe raportime të plota nga të gjitha nivelet e kompanisë për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

VII.1 Auditimi i Brendshëm

Ligji për ndërmarrjet publike parasheh që në kuadër të një ndërmarrje publike të formohet njësi për auditim të brendshëm. Kjo do të kryente funksionin e saj të pavarur dhe do të ushtronte detyrat me kompetencë.

Kompania ende nuk ka themeluar njësinë për auditim të brendshëm. Po ashtu, nuk është formuar as Komiteti i auditimit.

Konkluzion

Nga mungesë të themelimit të njësisë së auditimit të brendshëm kompania nuk ka arritur të krijoj një ambient të mirë të kontrollit. Themelimi i kësaj njësie do të forconte sigurinë e funksionimit të kontrollit të brendshëm, duke sugjeruar përmirësimet e nevojshme të sistemit.

Rekomandimi 10

Rekomandojmë Bordin e Drejtorëve që të siguroj:

- Themelimin e Njësine e Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit.

VIII. Konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Kompanisë

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i Kompanisë akoma nuk ka arritur të themeloj dhe funksionalizoj një kornizë të brendshme ligjore të përshtatshme, me udhëzimet dhe procedurat e shkruara, të cilat do të ofronin bazën e duhur për një menaxhim të shëndoshë dhe efikas të kompanisë. Mungesa e kornizës, përveç menaxhimit financiar, është reflektuar edhe në kontrollin e brendshëm të kompanisë, i cili nuk ka funksionuar në mënyrë të kënaqshme.

Problemet kyçe të kompanisë janë lidhur më trajtimin e të hyrave. Gjatë periudhës prej vitit 1999 e deri në vitin 2010, Kompania nuk kishte arritur një inkasim të kënaqshëm. Një vlerë e mjeteve të pa inkasuara kompania i kishte provizionuar si borxhe të këqija dhe të dyshimta që si pasojë e kësaj, pasqyrat financiare të kompanisë gjatë kësaj periudhe kishin rezultuar me humbje. Dhënia dhe mos kthimi i huasë rrit edhe më shumë mungesën e mjeteve qarkulluese.

Megjithatë, ne kemi vërejtur një progres në menaxhim. Pas rekomandimeve tona në vitin e kaluar, Kompania tashmë ka filluar të kalkuloj Koston e mallit/shërbimeve të shitura dhe të përmirësoj kontabilitetin shpenzimeve. Një zhvillim tjetër pozitiv është tendenca e rënies së dukshme të shpenzimeve, siç është rasti me shpenzimet e derivateve dhe shpenzimet tjera operative, të cilat ishin mbi 500 mijë euro më të ulta se vitin e kaluar.

Rekomandimi i përgjithshëm

Rekomandojmë Bordin Drejtues të Kompanisë që të rishikoj kornizën e brendshme ligjore si dhe politikat e tanishme, të analizoj mangësitë e theksuara të raportit, dhe të ndërmerr veprimet e mëtutjeshme përmirësuese.

Shtojca I. Komentet e KRM “Pastrimi” dhe përgjigja e ZAP-it

Menaxhmenti i Kompanisë KRM “Pastrimi” ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi Pasqyrat Financiare për vitin 2010 dhe është zotuar që do ti bëjnë përpjekjet për t’i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opioneve të Auditimit

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranura të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinion i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinionin e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinion i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionin i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionin i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.